




Pranuar / Dorezuar Prenjelo/Prodato Received/Delivery	20.01.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANDIJEK	236/2021		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr. 415/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A. nr.415/2020, të datës 14.12.2020, të parashtruara nga me adresë banimi Rr." Ajhidët" nr. 48, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.01.2021, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A. nr. 415/2020 të datës 14.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 14.12.2020, me nr. Prot:3110/2020, e regjistruar me A.nr. 415/2020, kundër përgjigjes së Komunës së Prizrenit, të datës 22.10.2019 me Nr.02-117-147629/02.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 16.12.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prizrenit. Këshilli me datë 14.01.2021, ka pranuar përgjigje në ankesë me nr. Protokolli 141/2021 nga Komuna e Prizrenit se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka administruar këto prova: Ankesën e datës14.12.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoli 3110/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 20.06.2016; Vendimin e datës 07.10.2019, Nr.01-118-143355 për përfundimin e marrëdhënies së punës për

shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Përgjigje në ankesë e datës 14.01.2021, me numër protokoll 141/2021, formulari për kërkesë apo ankesë, përgjigja në kërkesë e datës 22.10.2019

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa me numër A.415/2020 e datës 14.12.2020, është e pa lejuar, sepse:


Ankuesi në ankesë pretendon së përgjigja e Komunës së Prizrenit e datës 22.10.2019 me numër Nr.02-117-147629/02, është e kundërligjshme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar nga Këshilli që të aprovoj ankesën dhe ta detyroj Komunën e Prizrenit, që ankuesi t'i paguaj tri paga përcjellëse dhe tri paga jubilarë me kamatë ligjore, me rastin e pensionimit.

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës, Kolegji gjen se: Ankuesi ka qenë nëpunës civil në Komunën e Prizrenit, në pozitën e "Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile", në Departamentin e Administratës. Me vendimin e datës 07.10.2019 Nr.01-118-143355 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 27.09.2019. Pas kërkesës në formë elektronike për pagesë të tri pagave me rastin e pensionimit, ankuesi me datë 22.10.2019 ka pranuar përgjigje nga Komuna e Prizreni me të cilin është njoftuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk specifikon kompensimin e tri pagave për shkak të pensionimit. Ndërsa, kundër kësaj përgjigje ankuesi me datë 14.12.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka qenë në zbatim në kohën kur ankuesit i është lëshuar vendimi i datës 07.10.2019 Nr.01-118-143355 si dhe përgjigja e datës 22.10.2019, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës respektivisht Vendimin Nr.01-118-143355 të datës 07.10.2019, të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, si dhe përgjigjen e datës 22.10.2019 të Komunës së Prizrenit, Kolegji konstaton se ushtrimi i ankesës me datë 14.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pas konstatimit se ankesa është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji nuk u lëshua në shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Andaj bazuar në këto rrethana Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër Anr.415/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Kryetarit të komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së,